



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi

VENDIM

Nr 91, Datë 31 .05.2019

MBI

NJË NDRYSHIM NË “MARRËVESHJEN PËR SIGURIMIN E SHËRBIMIT TË SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NDËRMJET “OSHEE”SHA DHE FURNIZUESVE TË ENERGJISË ELEKTRIKE”, TË MIRATUA ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE NR. 24, DATË 15.02.2017 I NDRYSHUAR ME VENDIMIN NR. 58, DATË 15.04.2019

Në mbështetje të nenit 16, të Ligjit nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar; nenit 26 të “Rregullave të Organizimit, Funkcionimit dhe Procedurave të ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s, nr.96, datë 17.06.2016; nenin 19, pika 2 të “Marrëveshjes së shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike ndërmjet OSHEE sha, dhe furnizuesit të energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE Nr. 24, datë 15.02.2017, i ndryshuar me vendimin nr.58, datë 15.04.2019 , Bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 31.05.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, “Mbi ndryshimin e marrëveshjes për sigurimin e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike ndërmjet “OSHEE”sha dhe furnizuesve të energjisë elektrike”, të miratua me vendimin e bordit të ERE-s nr. 24, datë 15.02.2017 i ndryshuar me vendimin nr. 58, datë 15.04.2019”

Konstatoi se:

- ERE me vendimin e bordit nr.24, datë 15.02.2017 miratoi “*Marrëveshjen e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike ndërmjet OSHEE sha dhe furnizuesit të energjisë elektrike*”, ndryshur me vendimin e bordit nr. 58, datë 15.04.2019,
- Në vijim të kësaj procedure ERE ka miratur një sërë marrëveshjesh ndërmjet OSHEE sha dhe disa furnizuesve të energjise elektrike, të tilla si:
 - “*Marrëveshjen për sigurimin e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike që ka nënshkruar “OSHEE” sha me shoqërinë e licencuar në aktivitetin e furnizimit me energji elektrike “NOA ENERGY TRADE” shpk, miratura me vendimin e bordit nr.79, datë 06.04.2018.*
 - “*Marrëveshjen për sigurimin e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike që ka nënshkruar “OSHEE” sha, me shoqërinë e licencuar në aktivitetin e furnizimit me*

- energji elektrike "KASTRATI ENERGY" shpk, miratur me vendimin e bordit nr.74, datë 10.05.2019,*
- *"Marrëveshjen për sigurimin e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike që ka nënshkruar "OSHEE" sha, me shoqërinë e licencuar në aktivitetin e furnizimit me energji elektrike "GSA" shpk", miratur me vendimin e bordit nr.77, datë 06.04.2018.*
 - *"Marrëveshjen për sigurimin e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike që ka nënshkruar "OSHEE" sha, me shoqërinë e licencuar në aktivitetin e furnizimit me energji elektrike "GRID ENERGY" shpk, miratur me vendimin e bordit nr.111, datë 14.05.2018.*
 - *"Marrëveshjen për sigurimin e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike që ka nënshkruar "OSHEE" sha, me shoqërinë e licencuar në aktivitetin e furnizimit me energji elektrike ALBANIAN ENERGY SUPPLIER" shpk, (AES shpk), miratur me vendimin e bordit nr. 78, datë 06.04.2018,*
- Neni 20.1 i marrëveshjes tip përcakton se:
 - *"Kjo Marrëveshje hartohet në 5 kopje origjinale, në gjuhën Shqipe, secila me vlerë të njëjtë ligjore, 2 për secilën Palë dhe 1 për t'u dërguar për miratim në ERE"*
 - Duke qenë se marrëveshjet me furnizuesit, si më sipër cituar, lidhen konform *"marrëveshjes TIP"* miratur me vendimin e bordit te ERE-s nr.24, datë 15.02.2017, ndryshuar me vendimin nr. 58, datë 15.04.2019, është i panevojshëm miratimi rast pas rasti i të gjitha marrëveshjeve të lidhura mes *"OSHEE"* sh.a, dhe furnizuesve të licencuar në aktivitetin e furnizimit.

Për gjithë sa më sipër Bordi i ERE:

Vendosi:

- 1.** *Fillimin e procedurës për ndryshimin e nenit 20, pika 1 të "Marrëveshjes së shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike ndërmjet OSHEE sha, dhe furnizuesit të energjisë elektrike", miratur me vendimin e Nr. 24, datë 15.02.2017, i ndryshuar me vendimin nr. 58, datë 15.04.2019 si më poshtë :*
 - **20.1** *"Kjo Marrëveshje hartohet në 5 kopje origjinale, në gjuhën Shqipe, secila me vlerë të njëjtë ligjore, 2 për secilën Palë dhe 1 dërgohet në ERE për dijeni"*

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë subjektet e interesuara për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendrike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendrike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare

KRYETARI
Petrit AHMETI